VENDIM
Nr.92, datë 8.12.2009

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "EGL ALBANIA" SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9 dhe 13, pika 1 germa "d", dhe nenit 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e enrgjisë elektrike", të ndryshuar dhe neneve 4 germa "g", 15,13 dhe 14 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.12.209, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "EGL Albania" sh.a. për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike

dhe konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "EGL Albania" sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa "a", "b" dhe "c" është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa "a", "b", "c", "d", "f" dhe "g" është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal neni 9, pika 3, germa "a","b" dhe "d" është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik neni 9, pika 4.10 germat "a","b",dhe "c" është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "EGL Albania" sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta